



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 23.09.2025

Numër Protokolli: 6337/2025

A.nr.1472/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1472/2025, të datës 25.07.2025, të parashtruar nga ankuesi N.D, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*transferim i përhershëm*”, në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 23.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si bazuar ankesa me numër A.nr.1472/2025, e datës 25.07.2025, e parashtruar nga ankuesi N.D.

II. Anulohet Vendimi me Nr.1116/2025 i datës 11.07.2025, i Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për transferimin e përhershëm të ankuesit në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Pejë.

III. Obligohet Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e punës sipas akt emërimit.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi N.D (*referuar tutje vetëm ankuesi*), më datë 21.07.2025 përmes Postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 22.07.2025 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.1472/2025, kundër Vendimit me Nr.1116/2025 të datës 11.07.2025, të Sekretares së Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për transferimin e përhershëm në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Pejë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit më datë 10.09.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5048/2025 të datës 25.07.2024 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me Nr.1116/2025 të datës 11.07.2025 për transferimin e ankuesit; Zarin e datës 21.07.2025; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1472/202, të datës 10.09.2025; Akt Emërimi i datës 29.12.2015; Diplomë e ankuesit; Kopje e letërnjoftimit për ankuesin; Vendimin me Nr. 06/39 të datës 22.07.2015 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Kërkesën për zbatimin e vendimeve të qeverisë nga Drejtori i Departamentit të Buxhetit i MF për Ministrinë Financave datës 03.05.2017; ankuesin; ;Vendimin me Nr. 065/142 të datës 19.04.2017 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Listën e pagave për ankuesin janar, shkurt, mars, prill, maj qershor dhe korrik 2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 29.12.2015 ka qenë i punësuar në pozitën Administrator Teknik për Kontrollin e Mirëmbajtës, në DSPIMNQ, në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Tutje sipas provave të lëndës, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme më datë 11.07.2025, ka nxjerr Vendim me Nr. 1116/2025, me të cilin ka bërë transferimin e përhershëm të ankuesit nga pozita Administrator Teknik për Kontrollin e Mirëmbajtës, në DSPIMNQ në pozitën *Asistent Administrativ* në Qendrën për Regjistrimit të Automjeteve në Pejë, në kuadër të Drejtoratit për Regjistrimin e Automjeteve, në Agjencinë e Regjistrimit Civil.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton ligjshmërinë e Vendimit me Nr.1116/2025 të datës 11.07.2025, duke pretenduar se transferimi është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore sepse nuk është kërkuar pëlqimi i zyrtarit që është kusht ligjor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 10.09.2025, ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme me përgjigjen ndër të tjera si në vijim: *Me Rregulloren (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe me Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, pozita që mban ankuesi, nuk ekziston. Andaj me qëllim të sistemit të tij, me Vendimit me nr. 1116 të datës 11.07.2025 ankuesi transferohet në pozitën Asistent Administrativ në Qendrën për Regjistrimit të Automjeteve në Pejë, transferimi i bërë brenda kategorisë...Me shuarjen e pozitë që ka mbajtur sipas akt emërimit z. D, është detyrë e institucionit që nëpunësit të mos mbeten pa punë...pasi i është shuar pozita z. D. Ku transferim është i domosdoshëm pasi asnjë zyrtar nuk mund të gëzojë patë pa vijuar punën. Kërkon që ankesa të hedhet poshtë dhe vendimi me nr. 1116 i datës 11.07.2025 të mbetet në fuqi, ndërsa arsyet po thuajse të njëjta janë dhënë edhe në vendimin e kundërshtuar me ankesë.*

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, iu referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës së transferimit të përhershëm të nëpunësve civil, ju referuar dispozitave të nenit 65 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6 dhe 7, ku përcaktohet: *“1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Për rastet kur nëpunësja/i civil është e nivelit drejtues të ulët, mesëm apo të lartë, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 2. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit civil. 3. Përgatitja profesionale e nëpunës/it që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet. 4. Transferimi i nëpunës/it civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësen/in e drejtpërdrejtë, udhëheqësen/in më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunës/it civil. 5. Transferimi i nëpunës/it civil në një institucion tjetër të shërbimit civil, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunës/it dhe me marrëveshje në mes të institucioneve. 6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste: 6.1. kur gjendja e saj/tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor e pamundëson transferimin; 6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunës/it civil; 6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin. 7. Qeveria me akt nënligjor, me propozim të ministrisë përgjegjëse për administratë publike miraton rregullat për zbatimin e këtij neni.*

Kolegjit i Këshillit, ju referuar edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, respektivisht nenin 11 paragrafi 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6, ku përcaktohet: *1. Nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në një vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. 2. Për rastet kur nëpunësi civil është i nivelit të ulët, mesëm apo të lartë drejtues, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar. 3. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër që punëson nëpunës civilë. 4. Transferimi i nëpunësit civil brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit civil. 5. Transferimi i nëpunësit civil në një institucion tjetër që punëson nëpunës civilë, bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunësit dhe me marrëveshje në mes të institucioneve. 6. Refuzimi për transferimin e përhershëm mund të bëhet vetëm në këto raste: 6.1. kur gjendja e tij shëndetësore, dëshmuar me vërtetim mjekësor, e pamundëson transferimin; 6.2. nëse vendi ku do të transferohet gjendet më shumë se njëqind (100) km nga vendbanimi i nëpunësit civil; dhe 6.3. për arsye objektive të dëshmuar që e pamundëson transferimin.*

Kolegji i Këshillit, lidhur me arsyet e transferimit të ankuesit sipas vendimit të kundërshtuar me ankesë dhe përgjigjes në ankesë të datës 10.09.2025 të dhënë nga Ministria e Punëve të Brendshme, ka konstatuar se 22.01.2021 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Rregullorja (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ku sipas nenit 77, është përcaktuar: *Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës*, ndërsa me Vendimin Nr. 493/2023, të datës 31.03.2023, të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimi dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr.01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme e cila është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës më datë 31.03.2023, kurse sipas nenit 22 të kësaj rregulloreje është përcaktuar se: *Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës*, e për rrjedhojë pozitat e ankuesve nuk janë paraparë si pozita të tilla sipas këtyre rregulloreve.

Kolegji i Këshillit, referuar Vendimit me Nr. 1116/2025 të datës 11.07.2025 për transferimin e ankuesit dhe përgjigjes në ankesë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 10.09.2025, ku janë dhënë pothuajse arsyet e njëjta të transferimit, konstaton se edhe pse janë dhënë arsyet se transferimi është bërë për shkak që pozita e ankuesit nuk është paraparë sipas Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, transferimi është bërë mbi bazë të nenit 65 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë e ky kjo dispozitë i referohet vetëm transferimit të përhershëm për interes të institucionit, ndërsa në rastin kur kemi shuarje të pozitave të punës atëherë vie në shprehje neni 66 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, i cili ndër të tjera në paragrafin 3, ka përcaktuar: *3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet komisioni i ristrukturimit që shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi/i civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit/it në një pozitë të lirë, për të cilën i plotëson kërkesat e vendit të punës*, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, vlerëson se fillimisht është dashur që meqë janë në fuqi Rregullorja (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Rregullorja (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe meqë kemi shuarje të pozitave si në rastin e ankuesit, ligjërisht është dashur që të ndërmerren të gjitha verimet juridike që të formohet Komisioni i Ristrukturimit siç parashihet më nenin 66 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 13 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, e ku përmes këtij neni janë paraparë edhe veprimet në kuadër të kompetencave që duhet me i ndërmarr ky komision, mirëpo sipas shkresave të lëndës edhe pse pozita e ankuesit nuk është paraparë sipas rregulloreve të cekura më lartë, në rastin konkret të Ministrisë së Punëve të Brendshme nuk janë ndërmarr veprimet për formimin e Komisionit të Ristrukturimit dhe nuk janë ndërmarr veprimet për përfundimin e këtij procesi, dhe në mungesë të këtyre veprimeve atëherë transferimet bëhen me vendime nga ana e Sekretares së Përgjithshme të kësaj ministrie sikurse në rastin konkret të ankuesit. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se nëse do të kishim pasur një procesi të përfunduar nga Komisioni i Ristrukturimit atëherë edhe transferimi i nëpunësve civil që pozitave të tyre nuk janë paraparë me organizmin e brendshëm në pozita të kategorisë së njëjtë dhe që plotësojnë kushtet ligjore për transferim do të mund të konsiderohej i drejtë dhe ligjor, ndërsa në rastin konkret nëse i referohemi vendimit të kundërshtuar me ankesë, respektivisht Vendimit me Nr.1116/2025 të datës 11.07.2025, të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme, rezulton se arsyet e transferimit janë krejtësisht të tjera në raport me arsyetimin e dhënë në vendim, ngase edhe pse në vendimin e kundërshtuar respektivisht në arsyetim të tij është potencuar fakti se për arsyet e shuarjes së pozitës së ankuesit për shkak të mungesës së stafit dhe nevojës për përmbushjen e pozitave në Qendrat për Regjistrim të Automjeteve, konkretisht në Qendrën e Regjistrimit të Automjeteve në Pejë, është e nevojshme transferimi i tij, atëherë Kolegji i Këshillit, thekson se në këtë rast janë dy arsye të ndryshme dhe për secilën ka rregullim ligjor, pra, në rast të shuarjes së pozitave me rregullore për organizmin e brendshëm sikurse pretendohet ka ndodhur në Ministrinë e Punëve të Brendshme, transferimi duhet të jetë si rezultat i procesit të ristrukturimit, ndërsa në rast të transferimit për interes të institucionit duhet të ekzistojnë arsyet e tjera që i parasheh ligji, e në rastin konkret transferimi i përhershëm sipas dispozitave që janë aplikuar edhe në vendimin e kontestuar duhet të bëhet edhe më pëlqimin e nëpunësit civil siç parashihet me nenin 65 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 11 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, e që në rastin konkret nuk ka pas pëlqim të nëpunësit civil.

Kolegji i Këshillit, ka parasysh dispozitat ligjore në fuqi të aplikueshme lidhur me refuzimin e transferimit të përhershëm që janë përcaktuar me nenin 65 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publike dhe nenin 11 paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, mirëpo përderisa në rastet e transferimit të përhershëm brenda institucionit kërkohet pëlqimi i nëpunësi civil, atëherë edhe transferimi nuk mund të jetë i ligjshëm.

Kolegji i Këshillit për arsyet e cekura më lartë, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura më lartë, dispozitat e nenit 8 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publike, e për rrjedhojë i njëjti i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për këtë dhe arsyet e cekura më lartë Kolegji i Këshillit vendosi të aprovojë ankesën e ankuesi dhe të anuloj aktin e kundërshtuar me ankesë.

Përkitazi me konstatimet si më sipër, dhe duke marr parasysh faktin se pozita e ankuesit nuk është paraparë sipas Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Vendeve të Punës në ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Rregullores (ZKM) Nr. 03/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (ZKM) Nr. 01/2021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, atëherë në referim të dispozitave ligjore të cekura si më lartë, konstatimeve të dhëna në këtë vendim, Kolegji i Këshillit, konstaton se Ministria e Punëve të Brendshme, gjegjësisht Sekretarja e Përgjithshme e kësaj ministrie është e obliguar që të ndërmarr të gjitha veprimet që procesi i ristrukturimit të filloj e më pastaj organet tjera të përcaktuara me dispozita ligjore të përfundojnë këtë proces sipas kompetencave të dhëna ligjërisht, ndërsa deri përmbylljen e këtij procesi mos të behet ndonjë transferim i përhershëm i ankuesit pa u respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1472 /2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, N.D;
- Organit të punësimit: Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së.